



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **"Marisa" sh.p.k. & Company Murseli**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc"**, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **"Marisa" sh.p.k.**, e dt. 10.11.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc"**, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 06.11.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 06.11.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Marisa" sh.p.k., me datë 10.11.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc", me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.11.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Bazuar në Vendimin e OSHP-së, nr.656/20, dt.22.10.2020, sipas të cilit: "*Sigurimi i tenderit nuk tolerohet të ngatërrohet dhe se sipas LPP-së nëse ofertuesi nuk i plotëson kushtet e FDT-së shpallet i papërgjegjshëm*", tenderi juaj është eliminuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës